

VENDIM
Nr. 1088, datë 24.12.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS DHE TË PROCEDURAVE TË
REGJISTRIMIT E PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE PËR PRONARËT
PËRFITUES, SI DHE TË NJOFTIMIT NGA AUTORITETET SHTETËRORE
KOMPETENTE E NGA SUBJEKTET E DETYRUARA**

(ndryshuar me VKM nr. 273, datë 12.5.2021; nr. 328, datë 18.5.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7, 6, pikat 8, 9 e 10, e 15, pika 4, të ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Të gjithë termat e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa me termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) “Dokument shoqërues”, aktet në bazë të të cilave identifikohen e regjistrohen pronarët përfitues të subjektit raportues dhe lloji i kontrollit të pronësisë;

b) “Lloji i regjistrimit”, regjistrimi fillestar, ndryshimi ose përditësimi i të dhënave për pronarët përfitues.

c) “Kërkesa” është aplikimi që i drejtohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për kryerjen e veprimeve në regjistrin, sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

ç) “Regjistrim fillestar” është regjistrimi për herë të parë i pronarëve përfitues të subjekteve raportuese, në përputhje me parashikimet e ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

d) “Regjistrim i ndryshimeve” është regjistrimi i çdo ndryshimi faktik të personit të regjistruar më parë si pronar përfitues, sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues (zëvendësimi, shtimi i një personi të ri apo heqja e një personi nga regjistri i pronarëve përfitues), si dhe regjistrimi i çdo ndryshimi tjetër në të dhënat e regjistruara të pronarëve përfitues.

2. Kërkesa për regjistrimin fillestar, regjistrimin e ndryshimeve apo përditësimin e të dhënave të pronarëve përfitues bëhet sipas afateve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 5, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

3. Kërkesa për regjistrimin fillestar, regjistrimin e ndryshimeve apo përditësimin e të dhënave të pronarëve përfitues paraqitet nga personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, në përputhje me parashikimet e kreut II, të këtij vendimi.

4. Të gjitha dokumentet e lidhura me kërkesat e kryera pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) ruhen dhe arkivohen nga QKB-ja vetëm në formatin elektronik.

5. Ministri përgjegjës në fushën e ekonomisë, me propozimin e titullarit të QKB-së, miraton formularët e kërkesës, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për regjistrimin e pronarëve përfitues dhe të legjislacionit në fuqi.

II. PROCEDURAT E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E TË DHËNAVE NË REGJISTRIN E PRONARËVE PËRFITUES

1. Kërkesa për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese, që regjistrohen në regjistrin tregtar, paraqitet nga personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni që rregullon procedurat e regjistrimit fillestar të personit juridik në regjistrin tregtar.

2. Kërkesa për kryerjen e të gjitha regjistrimeve të tjera sipas këtij vendimi paraqitet nga personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, duke u identifikuar elektronikisht në sportelin elektronik të QKB-së nëpërmjet autentifikimit nga portali unik i shërbimeve qeveritare “e-Albania”. Pas këtij autentifikimi, personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues akseson sportelin elektronik dhe zgjedh llojin e regjistrimit që kërkohet të kryhet. Pas përzgjedhjes së llojit të regjistrimit, sistemi i informatizuar shfaq formularin përkatës të kërkesës, sipas formatit të miratuar, dhe hap dosjen elektronike, e cila mban numrin përkatës (një numër për çdo dosje ose aplikim), të dhënë nga sistemi i informatizuar (numri i çështjes).

3. Pas shfaqjes së formularit dhe hapjes së dosjes elektronike, personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues plotëson elektronikisht formularin, në të gjitha rubrikat e tij, sipas llojit të regjistrimit që kërkohet të kryhet.

4. Personi i autorizuar, për të përfaqësuar subjektin raportues, ngarkon në dosjen e hapur sipas pikës 2, të këtij kreu, dokumentet shoqëruese, që provojnë të dhënat që regjistrohen, të krijuara apo të konvertuara prej tij në format elektronik. Për çdo dokument të ngarkuar në dosjen elektronike, sistemi i informatizuar vendos një kod identifikimi elektronik të sigurt që lidh dokumentin me të dhënat e autentifikimit të personit.

5. Pasi personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues verifikon se të dhënat e plotësuara në formular dhe dokumentet shoqëruese, të ngarkuara në dosjen elektronike sipas pikës 4, të këtij kreu, janë të sakta, i konfirmon ato me mjete elektronike që garantojnë autenticitetin e origjinës dhe pacenueshmërinë e përmbajtjes së dokumenteve në format elektronik, të paktën, nëpërmjet nënshkrimit elektronik të avancuar të formularit të kërkesës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

6. Pas konfirmimit elektronik të kërkesës, sipas pikës 5, të këtij kreu, sistemi i informatizuar jep konfirmimin automatik të kryerjes së kërkesës nga sporteli elektronik, i cili përmban numrin e dhënë automatikisht nga sistemi i informatizuar (numrin e çështjes), i cili i mundëson aplikantit të ndjekë në çdo kohë gjendjen e procesit të regjistrimit.

7. Sistemi i informatizuar njofton, gjithashtu, personin e autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, në postën elektronike të deklaruar pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*, duke i dërguar kopje elektronike të formularit të kërkesës së plotësuar dhe të konfirmimit të kryerjes së kërkesës nga sporteli elektronik.

8. Me lëshimin e konfirmimit të kryerjes së kërkesës, sistemi i informatizuar kalon kërkesën dhe dokumentet shoqëruese në format elektronik te nëpunësit e autorizuar (regjistruesit) të QKB-së, për shqyrtim e vendimarrje.

9. *Për plotësimin e të metave në rastin e pezullimit të një kërkesë të paraqitur për regjistrim fillestar, të ndryshimeve apo përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues, zbatohen procedurat e parashikuara sipas këtij kreu.*

III. DOKUMENTACIONI DHE FORMA E KËRKUAR

1. Subjektet raportuese kanë detyrimin të ruajnë e të mbajnë të dhëna dhe dokumente shoqëruese të duhura, të sakta e të përditësuara, në bazë të të cilave përcaktohen pronarët përfitues të subjektit dhe lloji i kontrollit të pronarëve të tyre përfitues. Personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues në kërkesën elektronike për regjistrimin e pronarit përfitues bashkëlidh si dokumentacion shoqërues, në format elektronik, aktet, si më poshtë vijon:

a) Në rastin e regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues:

i. dokumentacionin që vërteton numrin unik të identifikimit dhe emrin e subjektit raportues, si dhe datën e regjistrimit të subjektit në regjistrin përkatës;

ii. dokumentacionin që vërteton të dhënat e identifikimit të pronarit përfitues, sipas pikës 3.2.1, të nenit 4, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues;

iii. *dokumentacionin e autoritetit kompetent regjistruar, që vërteton se pronari përfitues i regjistruar është zotërues i 25 (njëzet e pesë) % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit, të të drejtave të votimit ose të interesave të pronësisë, si dhe që përmban datën e përcaktimit si pronar përfitues; dhe*

iv. *çdo dokumentacion tjetër që zotëron subjekti raportues për identifikimin dhe regjistrimin e pronarit, përfitues të tij, sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, përfshirë datën e përcaktimit si pronar përfitues, nëse ky informacion nuk rezulton në dokumentacionin sipas nënndarjes "iii" të kësaj shkrirje.*

b) Në rastin e regjistrimit të ndryshimeve të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese:

i. dokumentacionin që vërteton numrin unik të identifikimit dhe emrin e subjektit raportues, si dhe datën e regjistrimit të subjektit në regjistrin përkatës;

ii. dokumentacionin që vërteton të dhënat e identifikimit të pronarit përfitues, sipas pikës 3.2.1, të nenit 4, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues;

iii. *dokumentacionin e autoritetit kompetent regjistruar, që vërteton se pronari përfitues i regjistruar është zotërues i 25 (njëzet e pesë) % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit, të të drejtave të votimit ose të interesave të pronësisë, si dhe që përmban datën e përcaktimit si pronar përfitues; dhe*

iv. çdo dokumentacion tjetër që zotëron subjekti raportues për identifikimin dhe regjistrimin e pronarit përfitues të tij, sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, përfshirë datën e përcaktimit si pronar përfitues, nëse ky informacion nuk rezulton në dokumentacionin sipas nënndarjes “iii” të kësaj shkronje.

c) Dokumentacioni i përcaktuar në nënndarjet “i” dhe “iii”, të shkronjës “a”, të kësaj pike, duhet të jetë hartuar brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues.

ç) Dokumentacioni i përcaktuar në nënndarjet “i” dhe “iii”, të shkronjës “b”, të kësaj pike, duhet të jetë hartuar brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrimin e ndryshimeve të të dhënave të pronarëve përfitues.

d) Në rast se pas shterimit të të gjitha mjeteve të mundshme për identifikimin e pronarit përfitues dhe nëse nuk ka arsye për dyshime, subjektet raportuese nuk arrijnë të identifikojnë si pronar përfitues individin, i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të 25 (njëzet e pesë) % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues, sipas përcaktimeve të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, atëherë subjektet raportuese duhet të identifikojnë e të regjistrojnë në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, si pronar përfitues, individin që:

- i. përcakton vendimet e marra nga një person juridik;
- ii. kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së organeve vendimmarrëse dhe/ose organeve ekzekutive të personit juridik.

Në këtë rast, subjektet raportuese duhet të mbajnë dokumentacionin që arsyeton dhe vërteton veprimet e ndërmarra për të identifikuar pronarin përfitues, sipas përcaktimeve të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

dh) Në rastin e përcaktuar në shkronjën “d”, të pikës 1, të këtij kreu, përveç dokumenteve të përcaktuara në shkronjën “a” ose në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij kreu, sipas rastit, subjektet raportuese duhet të dorëzojnë edhe një deklaratë me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit raportues, në të cilën të përcaktohen saktësisht hapat e ndërmarrë për identifikimin si pronar përfitues të individit, i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të 25 (njëzet e pesë) % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues, si dhe arsyet për identifikimin dhe regjistrimin në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, si pronar përfitues individin, sipas nënndarjeve “i” e “ii”, të shkronjës “d”, të pikës 1, të këtij kreu.

Deklarata me shkrim e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit raportues, e përcaktuar në këtë shkronjë, duhet të jetë hartuar brenda afateve të kërkuara për dokumentet e tjera të përcaktuara sipas shkronjës “a” ose shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu.

e) Në rast se pas shterimit të të gjitha mjeteve të mundshme për identifikimin e pronarit përfitues dhe nëse nuk ka arsye për dyshime, subjektet raportuese:

- i. nuk arrijnë të identifikojnë si pronar përfitues individin, i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të 25% ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues, sipas përcaktimeve të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues; dhe

- ii. nuk arrijnë të identifikojnë si pronar përfitues individin, sipas nënndarjeve “i” dhe “ii”, të shkronjës “d”, të pikës 1, të këtij kreu,

atëherë subjektet raportuese duhet të identifikojnë dhe të regjistrojnë në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, si pronar përfitues, individin/ët që mban pozicionin e drejtuesit/drejtuesve më të lartë të subjektit raportues. Në këtë rast, subjekti duhet të mbajë dokumentacionin që arsyeton dhe vërteton veprimet e ndërmarra për të identifikuar pronarin përfitues, sipas përcaktimeve të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

ë) Në rastin e përcaktuar në shkronjën “e”, të pikës 1, të këtij kreu, përveç dokumenteve të përcaktuara në shkronjën “a” ose në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij kreu, sipas rastit, subjektet raportuese duhet të dorëzojnë edhe një deklaratë me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit raportues, në të cilën të përcaktohen saktësisht hapat e ndërmarrë për identifikimin si pronar përfitues të individit, i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të 25 (njëzet e pesë) % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues, si dhe arsyet për identifikimin e

regjistrimin në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, si pronar përfitues, të individit/individëve të përcaktuar sipas shkronjës “e”, të pikës 1, të këtij kreu.

Deklarata me shkrim e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit raportues, e përcaktuar në këtë shkronjë, duhet të jetë bartuar brenda afateve të kërkuara për dokumentet e tjera të përcaktuara sipas shkronjës “a” ose shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu.

2. Personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, nëpërmjet kërkesës, konfirmon njësinë e dokumentit në format elektronik me origjinalin.

3. Dokumentet shoqëruese nuk duhet të përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe përmbajtja e tyre duhet të duket qartë, të jetë e lexueshme e të lejojë marrjen e imazhit elektronik të dokumentit.

4. Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe. Së bashku me dokumentin shoqërues në shqip, aplikanti mund të depozitojë edhe përkthimin e vërtetuar në gjuhë të huaj. Aktet private dhe dokumentet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe dhe të legalizohen sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

5. Në rast mospërputhjeje të dokumentit shoqërues në gjuhën shqipe me atë në gjuhë të huaj, ky i fundit nuk mund t’u kundrejtohet palëve të treta. Gjithsesi, palët e treta mund t’i kundrejtojnë subjektit të dhënat e përmbajtura në dokumentin në gjuhë të huaj, përveç rastit kur subjekti provon se i treti kishte dijeni për përmbajtjen e dokumentit në gjuhën shqipe.

6. Në rastin e një kërkesë sipas pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, paraqitet i njëjti dokumentacion i kërkuar sipas parashikimeve të mësipërme të këtij kreu, me përjashtim të dokumentacionit, që vërteton numrin unik të identifikimit së bashku me datën e regjistrimit të subjektit në regjistrin tregtar, si dhe ekstraktin e të dhënave të regjistruara të subjektit raportues, të lëshuar sipas legjislacionit përkatës që rregullon procedurat e regjistrimit në regjistrin tregtar. Dokumentet e kërkuara në lidhje me këtë kërkesë paraqiten në të njëjtat mënyra dhe në të njëjtin format me dokumentacionin e kërkuar sipas legjislacionit përkatës që rregullon procedurat e regjistrimit në regjistrin tregtar.

IV. PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KËRKESËS DHE ARSYET E PEZULLIMIT APO REFUZIMIT PËR REGJISTRIMIN E TË DHËNAVE TË PRONARËVE PËRFITUES TË SUBJEKTEVE RAPORTUESE

1. Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura sipas parashikimeve të krerëve II e III, të këtij vendimi, merren në shqyrtim nga nëpunësit e autorizuar të QKB-së për vendimmarrje, sipas radhës së paraqitjes së tyre.

2. Nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së verifikon:

a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është person i autorizuar për të bërë regjistrimin;

b) plotësimin e të gjitha të dhënave për pronarët përfitues të kërkuara nga ligji për regjistrin e pronarëve përfitues, si dhe dokumentet shoqëruese;

c) paraqitjen në formën e kërkuar të dokumentacionit shoqërues, që vërteton të dhënat që regjistrohen;

ç) faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tij nuk duket qartë, është e palexueshme apo pengon marrjen e imazhit elektronik;

d) nëse regjistrimi i të dhënave për pronarët përfitues është paraqitur brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligjin për regjistrin e pronarëve përfitues;

dh) faktin nëse janë shlyer sanksionet administrative të zbatuara, sipas parashikimeve të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

e) faktin nëse të dhënat që kërkohen të regjistrohen janë të ndryshme nga të dhënat e regjistrueshme, sipas dispozitave të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

5. Nëse nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së, pas verifikimeve sipas pikave të sipërpërmendura, vëren se kërkesa është në përputhje me parashikimet e ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues dhe të këtij vendimi:

a) në rastin e një kërkesë të paraqitur sipas pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, miraton kërkesën njëkohësisht me regjistrimin e subjektit raportues si person juridik në regjistrin tregtar;

b) në rastet e një kërkesë të paraqitur sipas pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, miraton kërkesën jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga paraqitja e saj.

6. Nëse nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së, pas verifikimeve sipas pikave të sipërpërmendura, vëren se kërkesa nuk është në përputhje me parashikimet e ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues dhe të këtij vendimi:

a) në rastin e një kërkesë të paraqitur sipas pikës 1, të kreu II, të këtij vendimi, jo më vonë se 1 (një) ditë pune nga marrja e kërkesës, pezullon veprimet për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues të subjektit raportues. Pezullimi i veprimeve sipas kësaj pike përbën shkak për pezullimin e procedurave të regjistrimit fillestar të personit juridik në regjistrin tregtar. Plotësimi i të metave që pengojnë regjistrimin kryhet nga subjekti raportues brenda afateve dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi që rregullojnë procedurat e regjistrimit në regjistrin tregtar si dhe me parashikimet e kreu III, të këtij vendimi. Mosplotësimi i të metave që pengojnë regjistrimin në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas këtij vendimi, nga subjekti raportues me pronësi direkte përbën shkak për refuzimin e aplikimit për regjistrimin e personit juridik në regjistrin tregtar sipas legjislacionit përkatës;

b) në rastin e një kërkesë të paraqitur sipas pikës 2, të kreu II, të këtij vendimi, jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga marrja e kërkesës, pezullon veprimet për regjistrimin e kërkesës dhe QKB-ja e njofton subjektin raportues sipas kreu VII, të këtij vendimi, për shkakun e saktë të pezullimit. Plotësimi i të metave që pengojnë regjistrimin kryhet nga subjekti raportues brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, në përputhje me parashikimet e kreu II dhe III, të këtij vendimi.

7. Në rastet e pezullimit të veprimeve sipas pikës 6, të këtij kreu, nëse subjekti raportues plotëson të metat që pengojnë regjistrimin, brenda afateve përkatëse, nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së miraton kërkesën sipas pikës 5, të këtij kreu. Në këto raste, regjistrimi mban datën e paraqitjes së kërkesës së parë.

8. Nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së refuzon kërkesën si vijon:

a) njëkohësisht me refuzimin e aplikimit për regjistrimin e personit juridik në regjistrin tregtar sipas legjislacionit përkatës, në rastin e një kërkesë të paraqitur sipas pikës 1, të kreu II, të këtij vendimi, nga një subjekt me pronësi direkte;

b) jo më vonë se 2 (dy) ditë pune pas përfundimit të afatit të përcaktuar sipas shkronjës "a", të pikës 6, të këtij kreu, nëse subjekti raportues me pronësi indirekte nuk plotëson të metat që pengojnë regjistrimin, në rastin e një kërkesë të paraqitur sipas pikës 1, të kreu II, të këtij vendimi;

c) jo më vonë se 2 (dy) ditë pune pas përfundimit të afatit të përcaktuar sipas shkronjës "b", të pikës 6, të këtij kreu, nëse subjekti raportues nuk plotëson të metat që pengojnë regjistrimin, në rastin e një kërkesë të paraqitur sipas pikës 2, të kreu II, të këtij vendimi;

ç) jo më vonë se 2 (dy) ditë pune pas paraqitjes së kërkesës, nëse të dhënat që kërkojnë të regjistrohen janë të ndryshme nga të dhënat e regjistrueshme, sipas dispozitave të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

9. Me refuzimin e një kërkesë, subjektet raportuese kanë të drejtë të riaplikojnë, sipas ligjit dhe këtij vendimi, paraqitja e së cilës trajtohet si kërkesë e re. Paraqitja e një kërkesë të re nuk çliron subjektin raportues nga sanksionet e parashikuara sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, në lidhje me moskryerjen e regjistrimeve të detyrueshme brenda afateve ligjore.

V. MËNYRA DHE AFATET E NJOFTIMIT NGA AUTORITETET SHTETËRORE KOMPETENTE, SI DHE MËNYRA E PËRDITËSIMIT APO E NDRYSHIMIT TË TË DHËNAVE NGA QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

1. Autoritetet kompetente shtetërore do të kenë akses elektronik të lirë, direkt dhe të pakufizuar në të dhënat e regjistruara në regjistër, në funksion të përmbushjes së detyrave të tyre ligjore që lidhen me inspektimin e Regjistrit të Pronarëve Përfitues dhe mbledhjen e të dhënave për pronarët përfitues.

2. Nëse gjatë përmbushjes së detyrave të tyre ligjore që lidhen me inspektimin e Regjistrit të Pronarëve Përfitues dhe mbledhjen e të dhënave për pronarët përfitues, autoritetet kompetente shtetërore (Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave; Banka e Shqipërisë; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit) konstatojnë se të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues nuk përputhen me të dhënat në posedim të autoriteteve kompetente shtetërore, atëherë, ato, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e konstatimit, njoftojnë QKB-në në mënyrë elektronike nëpërmjet Regjistrit të Pronarëve Përfitues, duke dërguar edhe dokumentet shoqëruese, që provojnë të dhënat që duhet të përditësohen në regjistër.

3. QKB-ja, jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga marrja e njoftimit nga autoritetet kompetente shtetërore, kryen përditësimin ose ndryshimin në regjistër të të dhënave të pronarëve përfitues të përcaktuara në njoftimin elektronik të tyre dhe të provuara me dokumentet shoqëruese përkatëse.

VI. MËNYRA DHE AFATET E NJOFTIMIT NGA SUBJEKTET E DETYRUARA, NË RASTET KUR TË DHËNAT E REGJISTRUARA NË REGJISTËR NUK PËRPUTHEN ME TË DHËNAT QË ZOTËROJNË, SI DHE MËNYRA E PËRDITËSIMIT APO E KONFIRMIMIT TË TË DHËNAVE TË PRONARËVE PËRFITUES NGA SUBJEKTET RAPORTUESE

1. Nëse një subjekt i detyruar, që i nënshtrohet ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, konstaton se të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues nuk përputhen me të dhënat që ai zotëron në përmbushje të detyrave të tij ligjore, lidhur me pronarin përfitues të një subjekti raportues, duhet, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e konstatimit, të njoftojë me shkrim subjektin raportues dhe QKB-në.

2. Me marrjen e njoftimit me shkrim nga subjekti i detyruar, QKB-ja, brenda 2 (dy) ditëve punë, publikon njoftimin në regjistër dhe njofton në mënyrë shkresore subjektin raportues për konstatimin e subjektit të detyruar.

3. Subjekti raportues, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të QKB-së, duhet:

a) të përditësojë në regjistër të dhënat për pronarët e tyre përfitues, sipas këtij ligji, nëse konstatimi i subjektit të detyruar është i saktë; ose

b) të konfirmojë në regjistër të dhënat për pronarët e tyre përfitues, të regjistruara më parë, nëse konstatimi i subjektit të detyruar nuk është i saktë.

4. Përditësimi në regjistër i të dhënave për pronarët e tyre përfitues do të bëhet sipas së njëjtës procedurë, të përcaktuar në kreun II, të këtij vendimi.

5. Në rastin e konfirmimit në regjistër të të dhënave për pronarët e tyre përfitues, ndiqen këta hapa:

a) Pasi është autentifikuar sipas pikës 4, të këtij kreu, personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues akseson sportelin elektronik në *e-Albania* dhe zgjedh llojin e regjistrimit që kërkohet të kryhet. Pas përzgjedhjes së llojit të regjistrimit, sistemi i informatizuar shfaq formularin e konfirmimit të së dhënës, sipas formatit të miratuar, i cili mban numrin përkatës (një numër për çdo dosje ose kërkesë), të dhënë nga sistemi i informatizuar (numri i çështjes), si dhe të dhënat e përgjithshme për subjektin raportues dhe të dhënat e detyrueshme për pronarët përfitues të subjektit raportues;

b) Pasi personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues verifikon se të dhënat e plotësuara në formular janë të sakta, i konfirmon ato me mjete elektronike që garantojnë autenticitetin e origjinës dhe pacenueshmërinë e përmbajtjes së dokumenteve në format elektronik, të paktën, nëpërmjet nënshkrimit elektronik të avancuar të formularit të kërkesës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

c) Me konfirmimin elektronik të kërkesës, sipas shkronjës “b”, të kësaj pike, personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues konfirmon automatikisht në regjistër edhe të dhënat për pronarët e tyre përfitues;

ç) Sistemi i informatizuar njofton, gjithashtu, personin e autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, në postën elektronike të deklaruar pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*, duke i dërguar kopje elektronike të formularit të kërkesës të plotësuar dhe të konfirmimit të kryerjes së kërkesës nga sporteli elektronik.

6. Në rast se subjekti raportues nuk vepron sipas pikës 3, të këtij kreu, atëherë QKB-ja dhe autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse do të ndërpresin shërbimet e tyre për subjektet raportuese deri në:

a) përditësimin e të dhënave për pronarët e tyre përfitues në regjistër dhe pagimin e gjobës, në rast se ky mospërditësim përbën edhe kundërvajtje administrative sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 13, të ligjit; ose

b) konfirmimin në regjistër të të dhënave për pronarët e tyre përfitues, të regjistruara më parë në regjistër.

VII. DISPOZITA PËR NJOFTIMIN E VENDIMEVE

1. Çdo vendim i QKB-së në lidhje me miratimin, pezullimin apo refuzimin e një kërkesë njoftohet nëpërmjet publikimit në regjistër. Data e njoftimit është data e publikimit në regjistër. Në rastin e një kërkesë për

regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese, që regjistrohen në regjistrin tregtar, njoftimi bëhet nga QKB-ja, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi që rregullon procedurat e regjistrimit në regjistrin tregtar.

2. Gjithashtu, vendimi i publikuar sipas pikës 1, të këtij kreu, i njoftohet me shkrim personit të autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, edhe në adresën e postës elektronike të deklaruar në sportelin elektronik, pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*.

3. Aplikanti, brenda afatit të paraqitjes së ankimit administrativ, sipas nenit 11, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, mund t'i drejtohet sektorit të informimit dhe asistencës së QKB-së, nëse dëshiron të diskutojë apo të sqarojë shkaqet e një vendimi për refuzimin e një kërkesë. Në këto raste, nëpunësit e sektorit të informimit dhe asistencës i japin sqarime paraprake aplikantit lidhur me vendimin për refuzimin e kërkesës.

4. Nëse në vijim të diskutimit apo të sqarimit të shkaqeve të një vendimi për refuzimin e një kërkesë aplikanti nuk është dakord me vendimin e QKB-së, atëherë aplikanti ka të drejtë të paraqesë ankim administrativ, sipas nenit 11, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

5. Ushtrimi i së drejtës së aplikantit për të diskutuar apo sqaruar shkaqet e një vendimi nuk është kusht për paraqitjen e një ankimi administrativ. Aplikanti mund të paraqesë menjëherë një ankim administrativ, sipas nenit 11, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, ndaj një vendimi të QKB-së.

VIII. AKSESI NË REGJISTRIN E PRONARIT PËRFITUES DHE TË DHËNAT E TIJ

1. Në Regjistrin e Pronarëve Përfitues janë publike dhe lirisht të aksesueshme të dhënat e regjistruara në regjistër, si më poshtë vijon:

- a) emri dhe mbiemri i pronarit përfitues;
- b) shtetësia;
- c) viti dhe muaji i lindjes;
- ç) data e përcaktimit të individit si pronar përfitues;
- d) lloji dhe përqindja e pronësisë:
 - direkte;
 - indirekte.

2. Çdo person i interesuar ka të drejtë të marrë, pa pengesa, ekstrakte elektronike për të dhënat që janë publike për pronarët përfitues të një subjekti raportues të caktuar.

3. Nëse personi i interesuar dëshiron të marrë ekstrakte në format shkresor, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, sipas formatit të miratuar nga ministri përgjegjës në fushën e ekonomisë, shoqëruar me mandatpagesën e tarifës përkatëse. QKB-ja, pas vlerësimit të kërkesës, lëshon ekstraktin në format shkresor, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

4. Ekstraktet lëshohen sipas formatit të miratuar nga ministri përgjegjës në fushën e ekonomisë, me propozimin e titullarit të QKB-së.

IX. DISPOZITA TRANSITORE

1. Regjistrimi fillestar i të dhënave për pronarët përfitues nga subjektet raportuese ekzistuese, të regjistruara në regjistrin tregtar me pronësi direkte, kryhet sipas pikave 2–5, të këtij kreu.

2. QKB-ja identifikon subjektet raportuese ekzistuese të regjistruara në regjistrin tregtar me pronësi direkte, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 6/2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020, Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar, nuk kanë përmbushur detyrimin për regjistrimin fillestar të pronarëve të tyre përfitues.

3. QKB-ja, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, brenda datës 30.6.2022, transferon nga baza e të dhënave ekzistuese në Regjistrin Tregtar në regjistrin e pronarëve përfitues të dhënat e pronarëve përfitues që identifikohen sipas përcaktimeve ligjore, në lidhje me subjektet e përcaktuara sipas pikës 2 të këtij kreu.

4. Detyrimi për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet e përcaktuara sipas pikës 2, të këtij kreu, qubet i përmbushur në datën e transferimit në regjistrin e pronarëve përfitues të të dhënave të pronarëve të tyre përfitues sipas pikës 3 të këtij kreu.

5. Subjektet e përcaktuara sipas pikës 2, të këtij kreu, kanë të drejtë të përditësojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues, që janë transferuar në regjistrin e pronarëve përfitues sipas pikës 3 të këtij kreu, duke paraqitur kërkesë sipas parashikimeve të kreut II, të këtij vendimi. Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga këto subjekte

për herë të parë, pas transferimit të të dhënave në regjistrin e pronarëve përfitues, nuk zbatohen kundërvajtje administrative.

6. Subjektet raportuese, të regjistruara në Regjistrin Tregtar me pronësi indirekte, si dhe subjektet raportuese të regjistruara në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 6/2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020, ‘Për regjistrin e pronarëve përfitues’”, të ndryshuar, nuk kanë përmbushur detyrimin për regjistrimin fillestar apo për regjistrimin e ndryshimeve të të dhënave të pronarëve të tyre përfitues, duhet t’i përmbushin këto detyrime brenda datës 30.6.2022, duke paraqitur kërkesë, në përputhje me parashikimet e kreut II, të këtij vendimi.

7. Ndaj subjekteve raportuese, që, brenda datës 30.6.2022, nuk përmbushin detyrimet sipas pikës 6, të këtij kreut, QKB-ja zbaton gjobën e parashikuar nga pika 4, e nenit 15/1, të ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar.

8. Subjektet raportuese ekzistuese, të regjistruara në Regjistrin Tregtar me pronësi indirekte, si dhe ato të regjistruara në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse ekzistuese, që rezultojnë me status të pezulluar, regjistrojnë pronarin përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, përpara kërkesës për ndryshimin e statusit të tyre në Regjistrin Tregtar apo në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse ekzistuese. Ndryshimi i statusit të këtyre subjekteve raportuese ekzistuese në Regjistrin Tregtar apo në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse bëhet pas verifikimit të kryerjes së regjistrimit të pronarit përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**